



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4968 /2021
Data: 12.07.2021

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 22.06.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetarë i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim , Kulturë, Rini dhe Sport), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024.
3. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026.
4. Informatë për sektorin e emergjencave.
5. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- ky dokument është përgatitur nga ekzekutivi i komunës dhe përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë ka të bëjë nga burimet e financimit komunal nga grandet e përgjithshme të arsimit , shëndetësisë dhe nga të hyrat vetanake . Në pjesën e dytë janë paraqitur objektivat dhe prioritet e komunës , plani afat mesëm, korniza e shpenzimeve buxhetore , plani i ndarjeve buxhetore sipas kategorive dhe sipas viteve, ndërsa pjesa e tretë ka të bëjë me deklaratën vizionin sipas performancës sipas drejtorive. Është mbajtur debati publik dhe propozimet do të i përcjellim në mbledhje të kuvendit të komunës. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- kërkoj sqarim për shifrat të cilat janë planifikuar për rritjet buxhetore për çdo vit. A bazoheni në të hyrat vetanake apo prej granteve.

Shabi Rexhallari thekson:- rritja që është planifikuar për vitin 2022 është në shumë prej 239,592.00 € dhe në kuadër të kësaj i kemi tri rritje te grandit i përgjithshëm, granti specifikë, te shëndetësia nuk ka ngritje për shkak se është i njëjtë. Te të hyrat vetanake është paraprë një rritje për shkak se është paraprë që qytetarët kanë obligime ndaj komunës qoftë në tatim pronë qoftë në biznese dhe qëllimi është që me i nxjerr borxhet të cilat i kanë qytetarët ndaj komunës.

Sabedin Hasallari thekson:- te objektivat e komunës për vitin 2022-2024 propozoj që si objektiv numër një të jetë sigurimi i ujit të pishëm për qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:-hartimi i PZHK-së e di që ka filluar shumë herët dhe më mirë do të ishte që me modifikuar me bërë përfundimi dhe me paraqitur një afat. Është paraprë rritja e shpejtë e të hyrave por çka ka ngecur te këto në vitet që po kalojmë e që duhet ne me rritur efikasitetin e të hyrave. Është paraprë mundësia për implementim e tarifave të reja , mirëpo tarifat duhet të implementohen për shkak se e kemi rregulloren për taksa e tarifa. Ishim me një trajnim për buxhetimin gjinorë dhe në trajnim u përcaktua se me ligj duhet të bëhet buxhetimi gjinorë dhe a është paraprë në objektivat që ju i keni planifikuar.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket çështjes së ujit janë kryer procedurat e prokurimit dhe është nënshkruar kontrata me kompaninë dhe CDI-ja do të financon në shumë prej 300 000 € , ndërsa komuna do të financon në shumë prej 160,000 € . Pritet që brenda javës me i filluar punimet dhe për atë nuk janë paraprë në kornizën afatmesme buxhetore.

Mallzum Qajani thekson:- çështja e ujit është bërë shumë dinamike në Han të Eleiz jo pse komuna nuk ka dashur që ta kryen atë punë por komuna gjithmonë ka qenë e penguar për shkak të ligjeve në fuqi të cilat nuk e lënë komunën me menaxhuar me atë segment, ndërsa kompetencë e menaxhimit është kompania “Bifurkacioni”, mirëpo për deri sa nuk bëhet krejt në rregull nuk e merr obligim. Ne e dimë që në vitin 2008 është dashur me marr në menaxhim . Janë kryer procedurat e tenderimit dhe është zgjedhur punë kryesi dhe po shpresojmë që tre apo katër muajt e ardhshëm ai problem do të zgjidhet duke bërë funksionalizimin e fabrikës, vendosjen e ujëmatësve në Han të Elezit dhe një pjesë të segmenteve në Han të Elezit. Në qoftë se menaxhohet mirë besojë që do të zgjidhet problemi i ujit të pishëm në Han të Elezit , mirëpo kjo do të varet prej kompanisë “Bifurkacioni se si do ta menaxhon . Si komunë do të angazhohemi maksimalisht dhe do t'i bëjmë punët tona dhe po shpresojmë dhe mendojmë që ka me u zgjidhur problemi. Plani zhvillimorë komunal është e vërtetë që është zgjatur pak por janë dy faktorë që kanë ndikuar , është pandemi e cila nuk na la me i zhvilluar procedurat e tubimeve publike , ndërsa në këtë vit është vonuar pak drafti i zyrtarit që është caktuar me përgatitur . Ky vit është viti zgjedhorë dhe nuk lejohen me marr vendim për zhvillim të procedurave.

Sabedin Hasallari thekson:- kompetencë e kujt është sigurimi i ujit të pishëm për qytetarët a është obligim i nivelit qendrorë apo i nivelit lokal.

Mallzum Qajani thekson:- Hani i Elezit i ka dy burime të ujit burimin e Gllloboqicës dhe Dimcës. Në vitin 2008 është ndërtuar fabrika dhe kontrata është nënshkruar nga tri palët që janë përfshirë komuna, CDI-ja dhe kompania "Bifurkacioni". Komuna ka investuar në shumë prej 200 000 € dhe mjetet tjera i ka dhënë CDI-ja, mirëpo kompania "Bifurkacioni" nuk ka ardhur me menaxhuar dhe fabrika ka dalur prej përdorimit. Vitin e kaluar është ardhur drejtori i CDI-së dhe gjatë bisedave ata u zotuan që do të investojmë 300 000 € dhe ne u dakorduam që pjesën tjetër me financuar komuna. Është shpallur tenderi në muajin shtatorë të viti 2020 por është anuluar, pastaj procedurat e tenderimit nuk janë hapur as në nëntor por në muajin shkurt të vitit 2021 por përsëri është anuluar dhe është hapur në muajin prill dhe janë kryer procedurat, është nënshkruar kontrata me kompaninë "Teuta" dhe prezent ishin edhe në komunë dhe kanë potencuar që do të fillojmë punimet. Ne po shpresojmë që në dy apo tri javët e ardhme do të fillojnë punimet. Do të bëhet funksionalizimi i fabrikës, ndërrimi i një pjese të një segmenti të rrjetit të ujësjes dhe vendosja e orëmatësve.

Mehmet Ballazhi thekson:- zakonisht po i gjeni arsyet, mirëpo realisht arsye nuk keni për shkak se janë tre mandate që shkon në përgjegjësin e komunës. Ju e dini që Ligji për Vetëqeverisje Lokale e parasheh që kompetencë e komunës është zgjidhja e problemit të ujit çfarëdo që të jetë ai. Arsyetimet janë siç duam me i dhënë na. Problemin e qytetarëve nuk mund ta arsyetojmë se ka marr apo nuk ka marr pjesë CDI-ja, apo ka qenë kompania "Bifurkacioni" dhe nuk e ka marr menaxhim sepse qytetarit nuk interesojnë këto gjëra por qytetari kërkon zgjidhje. Janë tre mandate që nuk është bërë zgjidhje dhe më mirë do të ishte që me ju kërkuar falje qytetarëve që nuk kemi mundur me arritur me zgjidh. Marrëveshjen me kompaninë "Bifurkacioni" e keni të nënshkrume jo për rritje të kapaciteteve por është për menaxhim të ujit. Ju keni bërë përpjekje me disa shpime që i keni shpenzuar afër 25000 € dhe nuk janë funksional.

Shabi Rexhallari thekson:- u përmend rritja e efikasitetit në inkasim dhe te tatimi në pronë me gjetur mundësitë për shkak se nuk po kemi zyrtarë të mjaftueshëm për me mundur me i mbledhur të hyrat për shkak se zyrtarët me punë shtesë i kemi. Për tarifat e reja bëhet fjalë për në shëndetësi sepse nuk janë të paraparë dhe ka menduar që në vitin tjetër me u shtuar. Buxheti gjinorë është parapërë dhe është në faqen e fundit që janë parapërë në tabela.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2022-2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- është plan i rëndësishëm në mjedis, i kemi pas dy obligime njëren e kemi pas me IP-në për hartimin e planit zhvillimorë dhe planin paraprak që e kemi pasur i ka kaluar afati dhe ne e kemi bërë një draft plan për veprim në mjedis. Plani ka për qëllim identifikimin e pikave për mjedis dhe planin e aktiviteteve për evitimin e defekteve për ndotjen e ajrit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2021-2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Teuta Shkreta thekson:- çështja e rrugës ka kufiri mendoj që është emergjente për qytetarët të cilët banojnë në ato pjesë për shkak të kolonës nga kamionët që bëhet. Është mirë me biseduar edhe me policinë që të mbahet rendi kur bëhet tollovi.

Refet Kalisi thekson:- është bërë problem ajo pjesë dhe ankesat, i kam parashtruar në organet përkatëse. Kemi biseduar edhe me policinë për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- a është bërë ndonjë veprim konkretë apo ndonjë projekt ideorë me paraqitur dikund dhe me potencuar që kjo është zgjidhja përfundimtare për shkak se policia herë kanë kohë dhe herë nuk kanë apo ndoshta në momentin kur është më i domosdoshëm nuk janë. Është mirë me biseduar me kompaninë “Sharrcem” dhe me Terminalin Doganorë që me mundur me bërë një zgjidhje.

Mallzum Qajani thekson:- na mund të japim ide por plan nuk kemi dhe policinë nuk mund ta obligojmë, mirëpo ideja është që ajo lagje me pasur vijën e vetë të qarkullimit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR SEKTORIN E EMËRGJENCAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka vazhduar edhe për një vit. Vitin e kaluar interesimi i qytetarëve ishte më i vogël për shkak të pandemisë dhe ankesa ka pasur për shkak të çmimeve të shërbimeve kadastrale. Në këtë vit interesim ishte më i madh dhe deri në fund të muajit maj i kemi pasur dymbëdhjetë aplikime.

Kryesuesi thekson:- prej se ka hyrë ligji në fuqi deri më tani sa kanë aplikuar.

Nexhmedin Daci thekson:- deri më tani i kemi pasur 29 aplikime dhe prej atyre 14 janë legalizuar, ndërsa tjerët janë në listë të pritjes për shkak se ende nuk i kanë rregulluar çështjet pronësore.

Kryesuesi thekson:-ligji që është miratuar më herët kushtet i ka pasur më të vështira dhe është menduar që me ligjin aktual do të ketë një far zbutje por përsëri nuk pat. Qytetarët e kanë hetuar se nuk janë kushtet e mira dhe për atë nuk janë të interesuar me i legalizuar, mirëpo defekti nuk është në nivel lokal por është te hartuesi i ligjeve për shkak se vetëm për me i bërë përgatitjen e dokumenteve kushton më shumë se legalizimi dhe për atë qytetarët nuk janë të interesuar. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- marrëveshjet të cilat i keni me kompanitë për pastrimin e kanalizimeve a kanë ndonjë orë të caktuar që duhet me ardhur ata në momentin që njoftohen. Kompaninë e njoftova që kam problem me kanalizimin por ishin në Ferizaj dhe kanalizimi hyri në podrum dhe u dashtë me bërë zgjidhje vetë. Kur të bëhen kontratat është mirë me i potencuar gjitha gjërat që mos me pasur pastaj probleme

Refet Kalisi thekson:- orë të caktuar nuk kanë por në momentin që njoftohen ata vijën dhe kryejnë shërbim. Është kompani serioze dhe e përgjegjshme por kanë qëlluar në Ferizaj dhe i duhet kohë deri tu ardhur prej Ferizajt dhe pastaj erdhën por zgjidhje kishe bërë vetë.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:03

Procesmbajtësi
Avni Bushi

